


**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**AKT PËRCJELLËS**

Për:	Menaxherin e prokurimit <b>Universiteti Publik "Kadri Zeka"</b> OE ankues <b>"Telekomi i Kosovës" Sh.A</b>	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP <b>Nr. 338/19</b>
Prej:	Ekspert shqyrtues i prokurimit <b>Muhamet Kurtishaj</b> 		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr.338/19 të parashtruar nga OE <b>"Telekomi i Kosovës" Sh.A</b> - Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit <b>"Furnizim dhe shërbime të internetit, VPN për Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan"</b> me nr. prok.941-19-4151-136		
Datë	04.07.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e dt:24.06.2019 me nr.338/19 të parashtruar nga OE **"Telekomi i Kosovës" Sh.A** - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim dhe shërbime të internetit, VPN për Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan"** me nr. prok.941-19-4151-136, iniciuar nga autoriteti kontraktues **Universiteti Publik "Kadri Zeka"**.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

**Ti dorëzohet:**

- Autoritetit Kontraktues
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues

Raporti i ekspertit shqyrtues për ankesën e parashtruar nga OE **"Telekomi i Kosovës" Sh.A** lidhur me aktivitetin e prokurimit **Furnizim dhe shërbime të internetit, VPN për Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan"** me nr. prok.941-19-4151-136, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Universiteti Publik "Kadri Zeka"**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

	02.07.2019	04.07.2019
Nënshkrimi i ekspertit	data e autorizimit të ekspertit.	data e dorëzimit të raportit

**N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit**

Me datën: 24.06.2019 OE “Telekomi i Kosovës” Sh.A - Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për kontrate lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim dhe shërbime të internetit, VPN për Universitetin Publik “Kadri Zeka” Gjilan” me nr.prok.941-19-4151-136 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Universiteti Publik “Kadri Zeka”.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues “Telekomi i Kosovës” Sh.A- Prishtinë

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues janë:

- Neni 9.4 i LPP-së– Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur

**DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:**

- Neni 9.4 — Përcaktimi i nevojave që duhet të Përbushen

Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 9 paragrafi 4, kërkon nga Autoritetet Kontraktuese që të veprojnë si në vijim: “autoriteti kontraktues kur është autoritet publik, autoriteti i tllë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t’u siguruar se lëndet që i përmbushin keto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik”.

Pra neni i lartë cituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevojë për sigurimin e shërbimeve operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik, për më tepër edhe interpretimi i KRPP-se thekson se një autoritet kontraktues publik nuk ka nevojë të procedoj ndonjë procedurë të prokurimit përderisa një shërbim ofrohet nga një autoritet tjetër kontraktues publik. Shih citatin e KRPP-se:

**Citati:**

36. Duke marr për bazë dilemat e shfaqura të Autoriteteve Kontraktuese dhe, kërkesat e shumta të tyre (drejtuar KRPP-es) që të behet e qartë se si duhet të veprohet në rastet kur një Autoritet Kontraktues



(Autoritet Publik) ka nevojë për sigurim të shërbimeve të cilat i posedon një Autoritet tjetër po ashtu publik? Konform nenit 87, paragrafit 2, nenparagrafit 2.8 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, KRPP ofron interpretim ligjor si në vijim.

Sa i përket çështjes së parashtruar më lartë, Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 9 paragrafi 4, kërkon nga Autoritetet Kontraktuese që të veprojnë si në vijim:

***"Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tulle publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lendet që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik".***

Pra neni i lartëcituarr rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevojë për sigurimin e shërbimeve operator i të cave po ashtu është një autoritet publik.

LPP, nuk e sqaron më tej se si autoritet publike do të rregullojnë plotësimin e nevojave të tyre (në mes vetë) meqë kjo është çështje e autoriteteve publike dhe/ose rregullave tjera.

Mirepo është mëse e qartë se këto raste kanë të bëjnë me Orjashtimet nga zbatimi i legjislacionit që rregullon prokurimin publik kur një formë e partneritetit publiko privat realizohet (një AK mund të kërkojë ofrimin e një shërbimi në shërbimet e tilla ose shërbimeve të një autoriteti tjetër kontraktues pa inicuar ndonjë procedurë tenderimi, të ashtuquajtura përjashtim "në shtepi").

Si përfundim pas analizimit të cekur më lartë (neni 9.4 të LPP-së) dhe të kërkesave tuaja, meqë nuk ka asnjë dispozitë tjetër të LPP-së e cila i obligon Autoritetet Publike që të marrin masa për të mos lejuar ashtremberimin e konkurrencës" (sikur ato nga direktiva e BE-së, neni 12.1) KRPP nuk ka se si të mos e trajtojë këtë çështje ashtu sikur është vendosur në nenin 9.4 të LPP-së.

KRPP, nuk do të publikoj asnjë lloj Njoftimi (Njoftimi për kontratë, Njoftimin për dhenie apo për nënshkrimin e kontratës) dhe do të deklarojë aktivitetet, vendimet dhe/ose kontratat jo ligjore në rast se nuk janë respektuar dispozitat e cekura më lartë apo cila do dispozitë tjetër e legjislacionit për prokurim publik.

#### **PROPOZIMI I TELEKOMIT TË KOSOVËS**

Të anulohet njoftimi për kontratë nga UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" GJILAN dhe të fillohet një procedurë e re në përputhje me interpretimin e KRPP-së dhe në kërkesat e nenit 9.4 të LPP-së. Dmth, bazuar në interpretimin e KRPP-së lidhur me nenin 9.4 të LPP-së, si dhe vendimet e Panelit Shqyrtues të OSHP-së për pretendimin e njëjtit ankimor të shqyrtuar në të kaluarën (vendimi nr. 162/19 i datës 30.05.2019, vendimi nr. 161/19 i datës 02.05.2019, etj.), UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" GJILAN nuk ka nevojë të përdorë procedurë të prokurimit, pasi që shërbimet në fjalë ofrohen nga një institucion publik që përdor fonde publike.

Menyra proceduese e anulimit është: UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" GJILAN duhet të kërkojë nga KRPP ose autorizim që të bëjë anulimin e Njoftimit për kontratë.

#### **Procesi i prokurimit:**

Data e njoftimit për kontratë:	17.06.2019
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Kontratë publike, furnizime
Vlera e parashikuar e kontratës:	9.999,00 €
Kriteri për dhënie të kontratës(N.52):	tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave:	24.06.2019
Data e hapjes së ofertave:	nuk është bërë
Data e përfundimit të rivlerësimit të ofertave:	nuk ka
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar apo të pa suksesshëm:	nuk ka
Data e njoftimit për anulimin e aktivitetit:	nuk ka
Data e kërkesës për rishqyrtim:	18.06.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim:	19.06.2019

Raporti i ekspertit shqyrtues për ankesën e parashtruar nga OE "Telekomi i Kosovës" Sh.A lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim dhe shërbime të internetit, VPN për Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan" me nr. prok.941-19-4151-136, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Universiteti Publik "Kadri Zeka"



Kriteret për vlerësim:

**Çmimi më i lirë**

### **III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE**

#### **III.2.1 Kërkesat e përshtatshmërisë**

Kërkesa 1.

Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe Ligjin Nr. 05 L-092.

#### **Dëshmia e kërkuar dokumentare**

Dëshmia 1.

Deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit Aneksi 2. Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë do të kërkojnë nga tenderuesi të cilit Autoriteti Kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të AK-së për synimin e dhënies së kontratës.

Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor të përmendur, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet, do ti konfiskohet garancioni i sigurimit të ofertes dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e radhës në rang-listë. Dokumentet të cilat do të kërkojnë si dëshmi për përmbushje të kërkesave të pranueshmërisë janë me se vijon.

I. Vërtetim të lëshuar nga gjykata apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit për situatën referuar nenit 65, paragrafi 3, nen-paragrafi 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nen-paragrafi 4.1, 4.2, dhe 4.4, (jo më e vjetër se 6 muaj para datës së dorëzimit të tenderit - kërkohej - origjinali ose kopja e noterizuar.

II. Një vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonësë për pagimin e tatimeve dhe kontributeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së dorëzimit të tenderit - kopja Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet me kontratë të sjellë dokumentet të kërkuara në piken, 1 dhe 2 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj, ta bejë konfiskimin e garancionit për sigurim të ofertës dhe të vazhdojë me shpërblyerje të kontratës me Operatorin Ekonomik që është rendit në vendin e dytë e kështu me radhë.

#### **III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:**

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose regjistrin e ndërmarrjeve në vendin tuaj të themelimit.
2. Regjistrimi i TVSH
3. Regjistrimi i numrit fiskal

#### **Dëshmia e kërkuar dokumentare**

- a. Certifikata e Regjistrimit të biznesit - Kopje
- b. Certifikata e TVSH
- c. Certifikata e numrit fiskal – KOPJE

**III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar**  
**NA**

**III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional**

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses 2 kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), të lidhura me Institucionet Publike ose Private.

***Dëshmia e kërkuar dokumentare***

Një liste të kontratave të realizuara, duke saktësuar, titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e kontratës dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat apo raportet e pranimi për punët e kryera.

**Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:**

Nuk ka

**Komisioni vlerësues pranë AK:**

**Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.**

Nuk ka

**Raporti i komisionit vlerësues:**

Nuk ka



## Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Telekomi i Kosovës" Sh.A - Prishtinë.

### Përgjigje në pretendimin 1.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 9.4 të LPP-së (Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur) për shkak se autoriteti kontraktues është autoritet publik dhe shërbimet e kërkuara poashtu ofrohen prej një operatori tjetër publik siç është "Telekomi i Kosovës" dhe në këto raste autoriteti kontraktues duhet të sigurohet që shërbime të tilla nuk janë në dispozicion nga një autoritet publik, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Autoriteti kontraktues në këtë rast Universiteti "Haxhi Zeka" është autoritet publik, po ashtu edhe "Telekomi i Kosovës" është autoritet publik, që të dy këto institucione janë pronë e qeverisë së Kosovës. Pikërisht për këto raste vlenë nenin 9.4 i LPP-së i cili thotë:

*"Nese autoriteti kontraktues eshte autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndet që i permbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik"*

Shtrohet pyetja logjike në zbatim të këtij neni të LPP-së, a është siguruar autoriteti kontraktues Universiteti "Haxhi Zeka" që për furnizimet që ka prokuruar në këtë aktivitet të prokurimit, nuk janë në dispozicion të një autoriteti tjetër publik.

Në bazë të dokumenteve që ka në dispozicion eksperti shqyrtues përgjigjeja në këtë pyetje është jo. AK Universiteti "Haxhi Zeka" nuk është siguruar që këto shërbime apo furnizime nuk janë në dispozicion në ndonjë autoritet tjetër publik. Kjo dëshmohet edhe me vet faktin që ka parashtruar ankesë, autoriteti tjetër publik "Telekomi i Kosovës" i cili ofron shërbime të tilla.

Për zbatim të kësaj dispozite ligjore, AK Universiteti "Haxhi Zeka" duhet ti shfrytëzoj shërbimet dhe furnizimet që i ofron "Telekomi i Kosovës". Pavarësisht arsyetimit të AK Universiteti "Haxhi Zeka" se kontrata e Telekomit e lidhur me Ministrinë e Administratës Publike nuk i ofron shërbimet e internetit VPN.

Pse qeveria, respektivisht ministria e administratës publike nuk ka pas nevojë për këto shërbime që ka tani Universiteti "Haxhi Zeka", këto shërbime mundën të ofrohen nga "Telekomi i Kosovës" vetëm për Universitetin "Haxhi Zeka" dhe atë prej datës kur universiteti e përfundon kontratën aktuale.

Universiteti "Haxhi Zeka" dhe "Telekomi i Kosovës" duhet të bashkpunojnë detyrimisht për këto shërbime që i duhen universitetit dhe ti diskutojnë kushtet për kryerjen e shërbimeve në fjalë, qoftë edhe çmimet në bazë të një marrveshje/kontrate të përbashkët. Por në asnjë mënyrë Universiteti "Haxhi Zeka" nuk mundet të kontraktoj këto shërbime/furnizime me operator tjerë privat kur këto janë në dispozicion te operatorit publik siç është tani "Telekomi i Kosovës". Prandaj ky pretendim ankimor është i **bazuar**.

### Mendimi i ekspertit shqyrtues

Autoriteti kontraktues me publikimin e njoftimit për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit, nuk e ka respektuar nenin 9 të LPP-së paragrafi 4.

Furnizimet/shërbimet që i duhen AK Universiteti "Haxhi Zeka" sipas kësaj dispozitet duhet të merren prej autopriteti publik që tani i ofron "Telekomi i Kosovës".

Bazuar në përgjigjejen e dhënë në pretendimin ankimor të OE ankues, si përfundim eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **Aprovohet** si e **bazuar**.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së rekomandon që autoriteti kontraktues Universiteti "Haxhi Zeka" ta **anuloj** aktivitetin e prokurimit **"Furnizim dhe shërbime të internetit, VPN për Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan"** me nr.prok.941-19-4151-136 dhe këto furnizime/shërbime ti shfrytëzoj nga OE ankues "Telekomi i Kosovës" SH.A si autoritet publik.